



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 09.06.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.06.2020 të parashtruar nga Grupi Operatorëve Ekonomik “Company Murseli” sh.p.k. & “Horn & Co. Kosova” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera”, me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik “Company Murseli” sh.p.k. & “Horn & Co. Kosova” SH.P.K., e dt. 05.06.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera”, me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1,, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 28.05.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .

2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 28.05.2020;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Grupi Operatorëve Ekonomik “Company Murseli” sh.p.k. & “Horn & Co. Kosova” SH.P.K., me datë 05.06.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e

prokurimit me titull **“Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera”, me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1.,**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 02.06.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Grupi Operatorëve Ekonomik **“Company Bejta” SH.A. & N.P.SH.”Eltoni Com” & “Eurocom” sh.p.k,** i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Grupi Operatorëve Ekonomik **“Company Bejta” SH.A. & N.P.SH.”Eltoni Com” & “Eurocom” sh.p.k,** nuk i ka të regjistruar kamionat e transportit nuk qëndron, sepse mos regjistrimi i kamionëve nuk është arsye për eliminim, meqë për shkak të pandemisë të gjithë kanë qenë të liruar nga rexhistrimi i automjeteve.

Tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se çmimi i juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gataj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës